



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 12
Prishtinë, më 19.06.2013, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N – 302.

PROCESVERBAL
I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali, kryetare, Biserka Kostiq, Rita Hajzeraj - Beqaj, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Kimete Bytyçi dhe Kymete Bajraktari,

Munguan: Justina Pula dhe Duda Balje.

Pjesëmarrës të tjerë: Elita Vokshi-OSBE; Nuredin Ibishi-UNDP; Florije Kryeziu-UNICEF; Besart Lumi-YIHR; Qendresa Mrasori- Praktikanete Kuvendi i Kosoves.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri, UNICEF.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtura me 22 dhe 28 maj 2013;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit për monitorimin e ligjit për barazi gjinore;
4. Shqyrtimi i kërkesave;
5. Të ndryshme.

Kryetarja – Konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 22 dhe 28 maj 2013

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 22 dhe 28 maj 2013.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit për monitorimin e Ligjit për barazi gjinore

Kryetarja – prezantoi raportin për monitorimin e ligjit për barazi gjinore dhe tha se është kryer një punë e madhe, nga Deputeti Kurtan Kajtazi është kërkuar që ky raport të plotësohet edhe me disa informata nga ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme se si është numri i të punësuarve i këtyre ministrive nëpër nivelin lokal, ato të dhëna janë nxjerr rekomandimet të cilat kanë dalë nga të gjeturat gjatë monitorimit të ligjit, por duhet të pësonin edhe ca ndryshime.

Albana Gashi- propozoi që rekomandimit 1.2 t'i hiqen fjalët rregullorja e UNMIK-ut .

Kryetarja- rekomandimi 2.2 duhet të ndryshoj dhe se dihet që ligji duhet të zbatohet por në këtë rast, Ne duhet me i paraparë sanksionet më të rrepta për mos zbatuesit e ligjit. Po ashtu rekomandimi 6 duhet të ndryshohet si në vijim „, zyrtari për barazi gjinore të jetë në kuadër të njësisë për të drejtat e njeriut dhe t'i caktohen kompetencat”.

Albana Gashi-tha se në rekomandimin 12, të behet një formulim më i qartë.

Kymete Bajraktari –sa i përket rekomandimit 1.2 tha që të shkruhet saktë përmbajtja, e mos të shkruhet rregullorja e Unmik-ut fare. Po ashtu rekomandimi 6 se nëpër komuna është vetëm një zyrtarë për njësitin e të drejtave të njeriut.

Kryetarja –propozoi që informatat që janë kërkuar nga ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme se si është numri i të punësuarve të këtyre ministrive nëpër nivelin lokal,, të kërkohen edhe nga të gjitha ministrinë tjera dhe pastaj nëse është e nevojshme të ndryshohen rekomandimet apo të plotësohen me të dhëna të reja.

Komisioni unanimisht vendosi që të kërkoj informata nëpër të gjitha ministrinë se si është numri i përfaqësimit gjinorë të këtyre ministrive nëpër nivelin lokal.

4.Shqyrtimi i kërkesave;

Rita Hajzerja- tha se kemi një peticion nga punëtorët e degës së Tekstilit, lëkurës dhe këpucëve me seli në Prizren, të cilëve u është privatizuar ndërmarrja dhe kërkojnë, pensione të parakohshme për këto gjenerata prej moshës 55 vjet, kërkojnë të krijohet një fond social për ata punëtorë prej moshës 55 vjet, kërkojnë që mardhënia e tyre e punës ti

nihet si e pandërprerë, kur janë larguar nga puna nga masat e dhunshme, kërkojnë që për të gjithë punëtorët e larguar nga puna, shteti i Serbisë t'i kthejë kontributet e këtyre punëtorëve dhe tua paguaj dëmshpërblimet.

Komisioni pasi shqyrtoj këtë peticion vendosi të nxjerr këtë

Përfundim

Ky peticion nuk bie në fushë veprimtarin e këtij Komisioni.

Rita Hajzerja- tha se kërkesa e dyte është e fshatrave të komunave nga Peja, Deçani dhe Istogu për shfrytëzimin e bjeshkëve dhe kullosave në kufirin me Republikën e Malit të Zi siç janë Ishtedimi dhe Zhlepi.

Komisioni pasi shqyrtoj këtë kërkesë vendosi të nxjerr këtë:

Përfundim

Kërkesa e paraqitur nga banorët e zonës e fshatrave të komunës nga Peja, Deçani dhe Istogu i plotëson kushtet formalo-juridike, por kjo çështje nuk bie në kompetencën e këtij Komisioni, prandaj kërkesa i dërgohet për shqyrtim Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor si Komision funksional.

6. Të ndryshme.

Kryetarja njoftoj komisionin se ditën e premte prej orës 10.00, në bibliotekën kombëtare është një ligjëratë me temën të drejtat e njeriut dhe vendet ne transicion, sot i marrim ftesat dhe duhet bërë konfirmim kush merr pjesë.

Kimete Bytyqi-Njoftoi për vizitën në repartin e gjinekologjisë në Pejë se si ishin kushtet atje, u tha se kishte mungese të stafit, të medikamenteve aspiratorëve që nevojiten gjatë operacionit etj.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali

